

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7895, DATE 27.01.1995 “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

I. GJETJET DHE PROBLEMATIKAT

Analiza e Sistemit të Drejtësisë e miratuar nga Komisioni i Posaçëm “Për reformën në Sistemin e Drejtësisë” me vendimin nr. 14 dt.30.7.2015 ka evidentuar disa probleme dhe mangësi të anës formale dhe strukture të Kodit Penal. Ato përfshijnë: i) rregullim të pamjaftueshëm të instituteve kryesore, si: lidhja shkakësore, tentativa, bashkëpunimi, konkurrimi i veprave penale etj.; ii) formulime të paqarta dhe kontradiktore midis neneve të ndryshme; iii) dënimet jo të përshtatshme për rëndësinë e disa veprave penale;

Në dokumentin e strategjisë, përkatësisht në objektivin 5 u parashikua përmirësimi i Kodit Penal me qëllim harmonizimin e tij me standartet e BE-së.

Në kuadër të përbushjes së objektivit për përmirësimin e Kodit Penal dhe harmonizimin e tij me standartet ndërkombëtare, ndryshimet ligjore **synojnë**:

- Shmangjen e paqartësive dhe parashikimin e koncepteve dhe përkufizimeve të sakta lidhur me termat e përdorur në KP.
- Qartësimin dhe plotësimin e disa termave dhe instituteve të Kodit Penal, e sidomos të dispozitive penale që lidhen me institutet e parashkrimit, amnistisë dhe rehabilitimit.
- Rishikimin dhe qartësimin e masave dhe kritereve të dënit penal për një pjesë të madhe të veprave penale.
- Harmonizimin e parashikimeve të veprave penale dhe sanksioneve me standartet evropiane.
- Vlerësimin e mundësisë për amendime në një periudhë afatshkurtër ose/dhe parashikimin për një Kod të ri Penal.

II. PROCESI I HARTIMIT TË PROJEKTLIGJIT DHE METODOLOGJIA E PUNËS

Më 13 prill 2016 EURALIUS dorëzoi draftin në Ministrinë e Drejtësisë me ndryshimet urgjente që kanë nevojë për një vëmendje të menjëherësme në lidhje me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Ministria e Drejtësisë përpunoi disa nene që kishin nevojë për ndërhyrje urgjente. Për hartimin e draftit u angazhuan Grupi i Punës i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik.

Projektligji i hartuar nga grupi i ekspertëve dhe sekretariati teknik i paraqiten Komisionit të Posaçëm të Reformës në Drejtësi për miratim në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

III. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT

Ligi penal shqiptar u miratua fillimi i vitit 1995, por është amenduar shpesh gjatë këtyre 20 vjetëve nga hyrja në fuqi. Si rezultat, Kodi Penal ka humbur koherencën e brendshme. Për më tepër, në gjendjen aktuale Kodi nuk reflekton disa nga detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë si dhe disa standarde të BE-së, që në të ardhmen do të jenë të detyrueshme.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara është që të japë përparësi rehabilitimeve për shkelësit më pak të rrezikshëm në vend të burgimit në mënyrë që të kontribuojnë në uljen e numrit të të burgosurve dhe për të lidhur dispozitat e Kodit Penal në fuqi me shërbimin e provës për lirimin më të hershëm me kusht të njëzetëve. Prandaj, këto ndryshime nuk rregullojnë apo ri-dizenjojnë zyrën e Shërbimit të Provës, as nuk shqyrtojnë funksionet e prokurorëve në përgjithësi. Gjithashtu, është e rendësishme të theksohet se ndryshimet e propozuara do të bëjë rregulloret aktuale më të qëndrueshme dhe efikase nëpërmjet fazave të ndryshme të procedurave, sipas qëllimeve kryesore të rehabilitimit. Qëllimi i rehabilitimit është për t'ju qasur faktorëve që kanë çuar në sjellje kriminale dhe, duke vepruar kështu, zvogëlojmë mundësinë e përsëritjes së shkeljeve. Nga ana tjetër, përdorimi i alternativave kundrejt burgimit reflekton një ndryshim rrënjosor në përqasjen ndaj krimít, shkelësve të ligjit dhe vendit të tyre në shoqëri, duke ndryshuar fokusin e dënitit nga izolimi në drejtësinë restauruese dhe ri-integruese. Alternativat e shoqëruara me mbështetjen e duhur për shkelësit, do të ndihmonte anëtarët e shoqërisë për të bërë një jetë pa modelet e sjelljes kriminale.

Qëllimi i këtij projektligji është saktësimi i kuptimit dhe përmbatjes së disa neneve për të cilat ekspert kanë bërë ndryshime.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT

4.1 Projektligji një vëmendje të veçantë i kushton të miturve si subjekt të veprave penale duke shtuar llojet e dënimive alternative me qellim riabilitimin e tyre duke i krijuar mundësi që organet e drejtësise në rastet kur vepra penale është kryer nga një i mitur të zbatoj ndaj tij masa edukuese dhe jo dënim me burg. Projektligji parashikon për herë të parë disa forma të reja të masave edukuese si: i) "qortimi" i cili jepet nga gjykata kur sjellja e të miturit kundrejt veprës së kryer, si dhe vullneti i tij për të mos kryer asnjë vepër penale tjetër tregojnë që qortimi do të arrijë qëllimin e masave edukative; ii) kërkimi i ndjesës ndaj viktimit (të dëmtuarit); iii) rikuperimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose pagesa e gjobës, sipas aftësive, të ardhurave dhe sendeve pasurore të tij; iv) përfshirja në punën e organizatave humanitare ose në aktivitetet që kanë lidhje me komunitetin ose mjedisin; v) mos-shkuarja në vende të caktuara ose aktivitete argëtimi ose qëndrimi larg personave të caktuar të cilët kanë efekt të dëmshëm ndaj tij; vi) nënshtrimi i një trajtimit profesional mjekësor ose trajtimit për varësinë nga droga ose varësi të tjera me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit të tij ligjor; vii) moslargimi për një periudhë të gjatë kohe nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij i zakonshëm, pa aprovimin e veçantë të marrë nga qendra për mirëqenje sociale.

Ndryshimet e propozuara përfshijnë në vetvete ndryshimet në lidhje me dënimin e të miturve duke patur parasysh që qëllimi kryesor është parandalimi i kryerjes së një vepre tjetër penale nga të miturit dhe sjelljen e tyre në rrugën e drejtë Propozimet në projektligj janë në pajtim me standardet dhe Konventat ndërkombëtare që ka ratifikuar Shqipëria.

Projektligji parashikon se Interesi me i larte i të miturit është qëllimi parësor i dënit penal ndaj tyre. Ri-integrimi në shoqëri dhe rehabilitimi i të miturit në konflikt me ligjin kanë epërsi ndaj dënit penal me burgim. Në ndryshim nga neni 51 i Kodit Penal në fuqi , projektligji parashikon se ndaj të miturit caktohen si masë dënim i)masat edukative; ii)burgim ;iii) dënime plotësuese. Gjykata në vendimin e saj në rast se ndaj të miturit që ka kryer një vepër penale e deklaron fajtor dhe vodos dënimin e ti më burg duket të argumentojë shkaqet dhe arsyet pse ndaj të miturit nuk mund të caktojë një masë edukuese .

Në ndryshim nga neni 51 i Kodit Penal në fuqi , projektligji përcakton se në rastin kur i mituri ka kryer disa krime dhe gjykata duhet te japë disa dënime apo te bashkojë disa dënime të dhëna edhe me pare, burgimi i të miturit nuk mund te tejkalojë shtatëmbëdhjetë vjet.

Gjithashtu projektligji i jep mundësi gjykatës që në rastet kur mendon te japë dënim me burgim për te miturin deri në gjashtë muaj, duhet te zbatuje dënitmet alternative, pavarësisht llojit te veprës penale te kryer nga i mituri. Për të miturit të dënuar me burg projektligji parashikon se i mituri mund të lirohet me kusht nëse ka vuajtur të paktën një të tretën e dënit të që është caktuar nga gjykata.

Ndryshimet e parashikuara ne projektligj, për të miturit , u lejon gjykatave të aplikojnë ndaj të miturit subjekt të veprës penale apo ndaj të miturit i cili përjashtohet nga përgjegjësia penale apo ndaj të miturit që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale të caktojë lloje të ndryshme masa edukuese ose alternativa dënim i një se mendon ta dënojë të miturin me burgim deri në 6 muaj. I dënuari me burgim i mitur ndryshtës nga një i dënuar tjetër me burgim ka të drejtë ti drejtohet gjykatës për të kërkuar lirim me kusht mjafton të ketë kryer të paktën 1/3 e dënit të caktuar nga gjykata.

Projektligji me shtimin e disa paragrafëve në nenin⁵⁹ të ligjit në fuqi, parashikon në mënyrë më të detaujar rastet kur gjykata , vodos pezullimi e dënit me burg.

4.2. Risi e projektligjit janë përmirësimi i dispozitave që parashikojnë alternativat e dënit (nenet 60, 60/a, 62,62/a 64) me qëllim që vendimet alternative të jenë të zbatueshme duke bërë të mundur mbikqyerjen e tyre nga institucioni i Shërbimit të Provës. Projektligji me përmirësimet dhe ndryshimet e bëra i krijon mundësi gjykatës që edhe në rastet e mosrespektimit nga i dënuari të alternativës së dënit të dhënë, të caktojë një detyrim tjetër ose të zgjasë periudhën e shërbimit të provës se sa të caktojë një dënim me burg.

Projektligji parashikon se në rastet kur i dënuari është përdorues droge apo alkoli,me pëlqimin e tij gjykata cakton që i dënuari t'i nënshtrohet një trajtimi, programi mjekësor ose rehabilitimi nga përdorimi i alkoolit ose narkotikëve . Për detyrimet e të dënuarit të vënë në prove , të përcaktuara në nenin 60 të Kodit Penal,Gjykata duhet caktoj një afat i cili duhet të parashikohet brenda afatit të periudhës së provës. Në rast se i dënuari i vënë në provë nuk zbaton detyrimet e caktuara nga gjykata , punonjësi i shërbimit të provës është i detyruar të njoftojë gjykatën që ka dhënë vendimin dhe prokurorin e ekzekutimeve

Bazuar në rekomandimit Rec(2003)22, projektligji u krijon mundësi për të kërkuar lirimin me kusht të gjithë të burgosurit e dënuar, duke përfshirë të burgosurit e përjetshëm. Në këtë raste

projektligji ka vlerësuar drejtë kohën e vuajtjes së dënimit me periudha e masave të mbikëqyrjes që duhet t'i caktohet të dënuarit të liruar më kusht ..Projektligji në nenin 64 të Kodit Penal parashikon se Gjykata mund te vendose lirimin para kohe me kusht të të dënuarit dhe pas kryerjes së gjysmës së dënimit.

4.3. Projektligji me ndryshimet e propozuara në afatet e parashkrimin e ndjekjes penale, synon që personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, që parashikojnë dënimini me burgim të përjetshëm të mos i shpëtojnë ndjekjes penale. Instituti i parashtrimit të ndjekjes penale nuk zbatohet për veprat penale të Seksionit I, Nenet 76 – 79c. Projektligji parashikon se nuk mund të bëhet ndjekja penale kur nga kryerja e veprës penale deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar dyzet vjet në rastin e krimeve të dënueshme me burgim të përjetshëm dhe njëzet vjet për krimet, të cilat mund të dënohen me më shumë se dhjetë vjet burgim. Projektligji në nenin 66 parashikon një afat 15 vjeçar për të shuar ndjekjen penale për krimet që parashikojnë dënimin deri në 10 vjet.

4.5. Për shkak të problematikës dhe rrezikshmërisë që paraqet transplant i paligjshëm i organeve dhe se rastet e hetuara kanë provuar se viktimi e kësaj vepre janë kryesisht fëmijët nga grupet vunerabel, se kjo vepër penale zakonisht kryhen nga një gruپi të strukturuar kriminal ose organizate kriminale në nenin 89/a projektligji shton dy paragrafë duke parashikuar se vepra penale e shitjes së transplanteve konsiderohen edhe rastet kur personi aburon me pozitën e tij ndaj një fëmije ose një personi tjetër veçanërisht të pambrojtur, më shumë se një herë ose në bashkëpunim, ose nëse këto vepra i shkaktojnë dëm të rëndë shëndetit të viktimit,

Nisur nga problematikat që konstatohen në hetimin e gjykimin e veprës penale të mashtrimit , projektligji me ndryshimin e propozuar kërkon të bëjë një qartësim të kësaj dispozite duke përkufizuar kuptimin e mashtrimit .

4.6. Me qëllim qetësimin dhe parashikimin e figurave të veprave penale kompjuterike dhe shumëlojshmërisë së konstatuar për kryerjen e tyre , ne projektligji ka ndryshuar përbatjen e neve 293/b dhe 293/c duke bërë një përcaktim më të qartë të këtyre vepër penale . Dispozitat nisur nga qëllimi dhe pasojat e ardhura , projektligji i parashikon si kundravajtje penale apo krim

Projektligji bën një përcaktim më të saktë dhe të qartë të këtyre veprave penale duke garantuar mbrojtur nga publikimi informimi mbi identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur, anonimë ose vulnerabël ose të një personi identiteti i të cilit është në procedurën për përfshirjen në programin e mbrojtës ose personit të përfshirë në programin e mbrojtjes.

Projektligji është i përbërë nga 17 nene

Deputeti

Vasilina Krysi 